



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2176/6 prot.

Datë 06/11/2023

V E N D I M
Nr.1128/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06/11/2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-64461-03-31-2023, me objekt: “*Ristrukturim dhe megrim I DB te sistemit te faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD*”, me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 26.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër SH.A

Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK*” në procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-64461-03-31-2023, me objekt: “*Ristrukturim dhe megrim I DB te sistemit te faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD*”, me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 26.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “*PRIMUS ALBANIA*” SHPK me NIPT: L42202028V dhe me adresë: *Rruga “Margarita Tutulani”, Pallati “Viridario I”, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A
Adresa: Shkodër, Koplík, Malësi e Madhe, Linaj- Gruemirë Rezervuari 4000 m3.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi ë Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.04.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-64461-03-31-2023, me objekt: “Ristrukturim dhe megzim I DB te sistemit te faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD”, me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 26.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës-Kanalizime Shkodër SH.A.

II.2. Në datën 26.06.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 05.07.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “PRIMUS ALBANIA ” SHPK	1.125.000 leke	skualifikuar
2. “Ei3 Softëare Solution” SHPK	1.170.000 leke	skualifikuar

II.4. Në datën 05.07.2023, operatori ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Referuar pikës 2.3.1 pika b) të Kriteve për Kualifikim OE duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore e shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi.

Primus Albania nuk ka paraqitur një vërtetim të tillë.

Referuar pikës 2.3.1 pika b) të Kriteve për Kualifikim OE duhet të paraqesë faturë tatimore të shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi.

Nexia Consulting nuk ka paraqitur një dokument të tillë.

Referuar pikes 2.3.2 të Kriteve për Kualifikim OE duhet të dëshmojë që ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar. OE duhet të paraqesë kontratat e punës, certifikatat përkatëse si dhe listëpagesat. Në kundërshtim me këtë pikë OE nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentacionet e sipërcituara.”.

II.5. Me datë 01.09.2023 është publikuar në SPE njoftimi i anulimit të procedurës.

II.6. Në datën 06.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3396 dhe me nr. 2176/2023 prot., datë 06.09.2023 e bashkimi të operatorëve ekonomikë “PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK”, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe kundërshtimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2176/2 prot, datë 06.09.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK” kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3396, dhe me numër protokoll nr. 2176/2023, datë 06.09.2023.

II.8. Në datën 08.09.2022, bashkimi i operatorëve ekonomikë “PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK” ka riparuar formularin e ankesës, protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr. 2176/3 prot., datë 08.09.2023, duke kërkuar kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe kundërshtimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.9. Në datën 12.10.2023, nëpërmjet shkresës nr. 2176/4 prot., me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesat e operatorit ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK”, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoj autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm shoqëruar me dokumentacionin përkatës, lidhur me veprimet e kryera nga autoriteti juaj kontraktor sipas parashikimeve të nenit 111 dhe nenit 114 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

II.10. Nëpërmjet shkresës me nr. 1198/1 prot., datë 17.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2174/5 prot., datë 23.10.2023 me objekt “Informacion në lidhje me shkresën nr. 2176/4 prot., datë 17.10.2023” është depozituar nga Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, në Komisionin e Prokurimit Publik, akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se nuk e ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK” duke argumentuar:

“Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 2176/4 prot, datë 12.10.2023, të protokolluar nga jonë me nr. 1198 prot, datë 16.10.2023, në lidhje me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë "PRIMIUS ALBANIA shpk & NEXIA AL CONSULTING sh.p.k", për procedurën e prokurimit me objekt "Ristrukturim dhe megrim i DB të sistemit të faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy he AD" me nr. reference 64461-03-31-2023 të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Shkodër, ju informojmë si më poshtë:

Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt- J66902052A është në proces likuidimi, pasi që nga data 01.09.2023 ka transferura të gjitha të drejtat dhe detyrimet tek subjekti me kompetenca të përbashkëta Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. Nipt - M378197010.

Ky transferim bazohet në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin, trajtimin dhe përpunimin e ujerave të ndotura", në vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 38, datë 26.07.2022 "Për pjesmarrjen e Bashkisë Shkodër në subjektin me kompetenca të përbashkëta, me qëllim kryerjen e shërbimeve ëte furnizimit me ujë të pishëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimin të ujerave të ndotura", në vendimin nr.3, datë 10.07.2023 të Asamblesë të Aksionarëve "Për zmadhimin e kapitalit dhe pranimin të aksionarit të ri Ujësjetllës Kanalizime Shkodër", në Kontratën noteriale për transferim aktivitetit nr. repertori 2722, datë 13.07.2023.

Për sa më sipër, referuar dosjes së prokurimit, Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr. nipt-J66902052A ka anuluar procedurën e tenderimit bazuar në proces -verbalin e vlerësimit të mbajtur nga KVO-ja dhe te me botimin e anulimit të procedurës publikuar në buletin nr.75, datë 04.09.2023.

Ankesa e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik "PRIMIUS ALBANIA shpk & NEXIA AL CONSULTING sh.p.k", nuk është shqyrtuar, për dy arsye:

Së pari; Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt- J66902052A ka mbyllur aktivitetin, pasi ky subjekt nga data 01.09.2023 ka transferuar të drejtat dhe detyrimet tek Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt-M378197010, për rrjellojë nuk ka asnjë të punësuar, përveç likujdatorit të shoqërisë dhe anëtareve të këshillit të administrimit.

Së dyti: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt- M378197010, nuk e ka shqyrtuar ankesën, për arsye se ankesa e bëre nga bashkimi i operatoreve ekonomik "PRIMIUS ALBANIA shpk & NEXIA AL CONSULTING sh.p.k" nuk i është drejtuar Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt- M378197010, por Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt- J66902052A. Në këto kushte e kemi patur të pamundur nga ana proceduriale për të marrë në shqyrtim ankesën.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë;

Kriteret kualifikuese të DST-ve

Vendim i KPP-së nr. 475/2023

Shtojcë për ndryshim të dokumentave të tenderit nr. 1133 prot, datë 13.06.2023

Proces-verbalin e vlerësimit të mbajtur nga KVO-ja, datë 04.07.2023

Kërkesë drejtuar KPP-së për heqje pezullimi të procedurës nr. 1247 prot, datë 07.07.2023

Vendim KPP-së nr. 596/2023

Vendim KPP-së nr. 642/2023

Botim i anulimit të procedurës nr. buletini 75, datë 04.09.2023."

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar, nuk kanë dorëzuar pranë KPP formularin e

argumenteve në përputhje me nenin 113 të LPP-së nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave dhe as në formë shkresore.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “PRIMIUS ALBANIA SHPK & NEXIA AL CONSULTING SHPK” për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të dhënë nga KVO-ja si në vijim: “Referuar pikës 2.3.1 pika b) të Kriterëve për Kualifikim OE duhet: të paraqesë vërtetim të lëshuar nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore e shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi.

Primus Albania nuk ka paraqitur një vërtetim të tillë.

Referuar pikës 2.3.1 pika b) të Kriterëve për Kualifikim OE duhet të paraqesë faturë tatimore të shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit të modifikuara “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.1 është parashikuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

“2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 20% te fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjate tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

III.1.2. Në shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit të modifikuara “FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT”, është publikuar nga ana e autoritetit kontraktor preventivi i shërbimeve për t’u realizuar objekt-prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 6

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

NR	EMËRTIMI	SASIA	ÇMIMI	VLERA	AFATI EKZEKUTIMIT
1	<i>Ristrukturim dhe migrim i DB te sistemit te faturimit AL Billing</i>	<i>1</i>			<i>1 muaj</i>
2	<i>Ngritje dhe Konfigurim Proxy Server</i>	<i>1</i>			<i>1 muaj</i>
3	<i>Ngritje dhe Konfigurim i AD group policies</i>	<i>1</i>			<i>1 muaj</i>

III.1.3. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, “*TERMAT E REFERENCES*”, është publikuar nga ana e autoritetit kontraktor specifikimet teknike dhe detyrat për t’u realizuar objekt-prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 7

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Situata Aktuale në UK

Shoqëria Ujësjetës Kanalizime Shkodër përdor Sistemin e Faturimit AL-BILLING për Administrimin e Abonentëve, Faturimin, Arkëtimin, Ankesë/Kërkesat si dhe Faturën Online dhe atë të Leximeve AL-BILLING AMS MOB 4.4.4 për realizimin e leximeve të matësave nga Lexuesit në terren dhe administrimin e tyre (marrjen online dhe kalimin e tyre për faturim).

1. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

1.1. Objektivi i Përgjithshëm

- ✓ *Migrimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Faturimit Al-Billing*
- ✓ *Migrimi i bazës së të dhënave të Faturës Online*
- ✓ *Migrimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Leximeve*
- ✓ *Konfigurimet e nevojshme të aplikimit dhe moduleve të lidhura me sistemin e Faturimit Al-Billing*
- ✓ *Konfigurimin e Proxy server qe stafi te kufizohet ne aksesin e faqeve online*
- ✓ *Konfigurimin e AD dhe politikave të sigurisë për kufizim aksesesh*

1.2. Qëllimi

Implementimi i serverit të ri për Sistemin e Faturimit Al-Billing, ku të sigurohet vijimësia e punës për administrimin e abonentëve, faturimit, pagesave dhe realizimin e leximeve nëpërmjet pajisjeve mobile (PDA) nga lexuesit, migrimi i të dhënave dhe përmirësimi i procesit të administrimit dhe kontrollit të të akseseve.

1.3. Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori

- ✓ Instalimi, Konfigurimi dhe migrimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Faturimit Al-Billing
- ✓ Konfigurimi dhe Migrimi i bazës së të dhënave të Faturës Online
- ✓ Konfigurimi dhe Migrimi i bazës së të dhënave të Leximeve Online
- ✓ Konfigurimet e nevojshme të aplikimit dhe moduleve të lidhura me sistemin e Faturimit Al-Billing
- ✓ Konfigurimin e Proxy server që stafi të kufizohet në aksesin e faqeve online
- ✓ Konfigurimin e AD dhe politikave të sigurisë për kufizim aksesesh
- ✓ Qendrueshmëria dhe Zgjerueshmëria e Sistemit në serverin e ri
- ✓ Ruajtja e historikut të të dhënave dhe ndryshimeve të kryera për faturimin, faturën online dhe leximet
- ✓ Sigurimi që nuk pengohet procesimi i pagesave nga palet e treta (posta, ëëu, moneygram, easypay, etj.)
- ✓ Dokumentimi i procesit dhe dorëzimi i raportit përfundimtar tek IT

2. SUPOZIMET DHE RISQET

2.1. Supozimet e Projektit

Realizimi i këtij projekti bëhet nën supozimin që do të ketë një përfshirje total të aktorëve kyç si në midrimin dhe implementimin e sistemit Al-Billing, integrimin e moduleve dhe të dhënave, apo trajnimit të përdoruesëve.

Përfshirja e plotë e aktorëve kyç është thelbësore për mbarëvajtjen me sukses të projektit.

2.2. Risqet

Mos përfshirja e të gjithë aktorëve kyç do të sjellë mangësi në zhvillim, implementim dhe funksionalite të kërkuara si dhe në saktësinë e të dhënave.

3. QËLLIMI I PUNËS

3.1. Të përgjithshme

Institucioni administrues pranë të cilit do të realizohet implementimi lidhur me Sistemin AL-BILLING, Migrimet, Faturën Online dhe Sistemin e Leximeve për Leximet me Mobile (PDA) dhe dorëzimi i raportit përfundimtar do të jetë Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Shkodër Sh.a.

3.1.1. Përshkrimi i detyrës

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Shkodër Sha kërkon që të:

- ✓ Implementimi, përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Abonentëve
- ✓ Implementimi, përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Faturave
- ✓ Implementimi, përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Pagesave
- ✓ Implementimi, përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Ankesë/Kërkesave
- ✓ Implementimi, përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Akt-Marrveshjeve
- ✓ Implementimi, përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Faturës Online
- ✓ Implementimi, përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Leximeve Online
- ✓ Kontrolle shtesë për kalimet e të dhënave dhe konfirmim me aktualet para migrimit
- ✓ Integrimet e aplikimeve dhe lidhjeve të tyre me bazën e të dhënave

- ✓ Saktësimi i database links dhe database jobs referuar proceseve si dhe dokumentimi I tyre
- ✓ Saktësimi i database jobs për kryerjen automatike dhe skedulimin e saktë të backup-eve
- ✓ Konfigurimin e Proxy server qe stafi te kufizohet ne aksesin e faqeve online
- ✓ Të përcaktohen kufizimet sipas përcaktimeve të faqeve zyrtare që do të jepen nga IT UKSH
- ✓ Konfigurimin e AD dhe politikave të sigurisë për kufizim aksesesh
- ✓ Të përcaktohen politikat e sigurisë për kufizimet sipas përcaktimeve që do të jepen nga IT UKSH
- ✓ Qendrueshmëria dhe Zgjerueshmëria e Sistemit për 5 vite
- ✓ Ruajtja e historikut të të dhënave dhe ndryshimeve të kryera për faturimin, faturën online dhe leximet
- ✓ Sigurimi që nuk pengohet procesimi i pagesave nga palet e treta (posta, ëëu, moneygram, easypay, etj.)
- ✓ Raportimi tek IT për aktivitetet e kryera me bazat e të dhënave

3.1.2. Hapësira gjeografike

I gjithë procesi i implementimit, përshtatjes, dhe migrimi i të dhënave, si dhe shërbimet e tjera do të kryhen dhe implementohet në zyrat kryesore të Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sha.

3.1.3. Siguria e Sistemit

Kërkesat për sigurinë e informacionit de kalimit të të dhënave janë të përcaktuara qartësisht në seksionet e kërkesave funksionale dhe atyre teknike, ku në cdo rast do siguroar integriteti I të dhënave dhe kalimi I plotë I tyre duke përfshirë edhe konfigurimet dhe integritet e nevojshme. Në cdo rast baza e të dhënave aktuale nuk do të lëvizet pa konfirmimin, kontrollin dhe sigurimin e vijimësisë në bazën e re tv vendosur n serverin e ri për këtë qëllim.

Të gjithë të dhënat e ruajtura në aplikacion, përfshirë edhe ato të konfigurimeve si dhe të përdoruesëve të sistemit duhet të ruhen të pa prekura dhe cënuara duke siguroar që plotëson kërkesat në lidhje me integritetin e të dhënave dhe sigurisë.

III.1.4. Nga verifikimi në sistemin elektronik, u konstatua se shoqëria “PRIMUS ALBANIA” SHPK ka dorëzuar ofertë në këtë procedurë prokurimi si përfaqësuese e bashkimit të operatorëve ekonomikë “PRIMIUS ALBANIA SHPK & NEXIA AL CONSULTING SHPK”. Ky bashkim operatorësh ekonomikë është krijuar në bazë të “Kontratë bashkimi shoqërishtë”, të nënshkruar më datë 22.06.2023, ku këta dy operatorë ekonomikë kanë rënë dakord që të krijojnë këtë bashkim shoqërishtë për të dorëzuar ofertë në këtë procedurë prokurimi objekt-ankimi, duke përcaktuar përqindjen e pjesëmarrjes dhe zërat konkretë të shërbimeve që marrin përsipër që të kryejnë në rast se shpallen fitues, si më poshtë:

- Shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK do të mbulojë 90.67 % të angazhimit të kontratës kryesore me autoritetin kontraktor, duke marrë përsipër të realizojë zërat e shërbimit si në vijim: “Zërin; ‘Ristrukturim dhe migrim i B të sistemit të faturimit AL Billing’ dhe zërin ‘Ngritje dhe konfigurim Proxy Server’.”.

- Shoqëria “NEXIA AL CONSULTING” SHPK do të mbulojë 9.33 % të angazhimit të kontratës kryesore me autoritetin kontraktor, duke marrë përsipër të realizojë zërin e shërbimit si në vijim: “Zërin; ‘Ngritje dhe konfigurim i AD group policies’.”.

III.1.5. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të këtij kriteri, anëtari i bashkimi të operatorëve ekonomik të sipërpërmendur dhe konkretisht shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK për plotësimin e kriterit kualifikues të shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit të modifikuar “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.1 ka paraqitur në sistem dokumentacionin si më poshtë:

1. Faturë tatimore elektronike nr. **74/2023**, datë 14.06.2023, të lëshuar nga shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK për shoqërinë private “Eestern Balkan Alliance”, me objekt: “Realizim konfigurim Proxy Server”, me vlerë 58.000 leke (pa-TVSH).
2. Kontratën me nr.prot 01/1, datë 11.01.2023, të lidhur midis shoqërisë “PRIMIUS ALBANIA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Fier SH.A, me objekt: “Përditësim i programit të faturimit, migrim i të dhënave dhe ëeb-service për pagesat e faturat e ujit të pijshëm”, me vlerë 6.590.000 lekë pa-TVSH, me afat 12-muaj nga data e lidhjes së kontratës, shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:
 - Aneksi 1 “Termat e referencës” me numër protokoll nr. 01/02 prot, datë 11.01.2023.
 - Formular i kontratës nr. 01/3 prot, datë 11.01.2023
 - Faturë tatimore elektronike nr. **16/2023**, datë 10.02.2023, të lëshuar nga shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK për autoritetin kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA, me objekt: “Zh& adaptim i sist te faturimit dhe arketimit, si dhe Përshatje & Migrim i të dhënave të ujësjiellësit”, me vlerë 1.890.000 leke (pa-TVSH).
 - Faturë tatimore elektronike nr. **30/2023**, datë 17.03.2023, të lëshuar nga shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK për autoritetin kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA, me objekt: “Prog per lex e matësive dhe integrim me Prog e fat, si dhe Pajisje PDA per leximin e matësive”, me vlerë 3.940.000 leke (pa-TVSH).
 - Faturë tatimore elektronike nr. **50/2023**, datë 26.04.2023, të lëshuar nga shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK për autoritetin kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA, me objekt: “Zhvill 7 implementim Shërb të pagesave Online”, me vlerë 760.000 leke (pa-TVSH).

III.1.6. Në nenin 77, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 4, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”.

III.1.8. Në nenin 55 “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” pika 4/b, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet se:

“4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. 42 Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

a) Për kontratat e punëve: i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”.

III.1.9. Në nenin 14 “*Operatorët ekonomikë*” ë ligjit nr. 162/2020, datë 23 .12.2020 “*Për prokurimin publik*” përcaktohet se:

“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kritereve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.10. Në nenin 88 “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” ë Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar përcaktohet se:

1. *Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*
2. *Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*
3. *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*
4. *Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*
5. *Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.*
6. *Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*
7. *Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.*

III.1.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj

autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.12. Fillimisht KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të kërkesës kualifikuese lidhur me eksperiencën e mëparshme, të dokumentacionit provues të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes dhe të arsyes së skualifikimit të dhënë nga ana e autoritetit kontraktor gjatë vlerësimit të dokumentacionit të ofertës së paraqitur nga ky ankimes.

Fillimisht, referuar dokumenteve të tenderit vërehet, se procedura e prokurimit objekt-prokurimi është e llojit “Shërbim” dhe konkretisht autoritetit kontraktor kërkon që të realizojë blerjen e shërbimit: **“Ristrukturim dhe megrim I DB te sistemit te faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD”**.

Gjithashtu, në dokumentet e tenderit të modifikuara dhe konkretisht në Shtojcën 8, pika 2.3.1 autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues lidhur me shërbimet e mëparshme të ngjashme, ku nga ana e entit prokurues është kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues për përmbushjen e këtij kriteri duhet që të kenë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të fituesit, shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% e fondit limit dhe përkatësisht në një vlerë jo më të vogël se 300.000 leke pa-TVSH. Për të plotësuar këtë kriter kualifikues duhet që në rastin e shërbimeve të ngjashme të realizuara me ente publike të dorëzojnë vërtetim të lëshuar nga enti publik ku të vërtetohet përmbushja me sukses e kontratës, si dhe vlera e afati i përfundimit të kontratës ose të dorëzohet fatura tatimore e shitjes, e plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ndërsa në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Pra, për përmbushjen e këtij kriteri kualifikues, operatorët ekonomikë ofertues duhet që të paraqesin vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes së shërbimit të lëshuar për entin publik, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, ndërsa në rastin e shërbimeve të ngjashme të realizuara me subjekte private duhet të dorëzohen fatura tatimore të shitjes të lëshuara për subjekte private, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, por këto dokumente duhet të jenë të lëshuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe vlera pa TVSH e këtyre shërbimeve duhet që të jetë jo më pak se vlera 20% e fondit limit dhe konkretisht jo më pak se vlera 300.000 leke.

Në rastin konkret operatori ekonomik ofertues “PRIMUS ALBANIA” SHPK ka ofertuar si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik “PRIMIUS ALBANIA SHPK & NEXIA AL CONSULTING SHPK” dhe për përmbushjen e këtij kriteri kualifikues referuar parashikimit

të nenit nenin 88 “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, duhet që këtë realizuar furnizime të ngjashme në vlerën 272.010 leke pa-TVSH, ne raport me përqindjen e bashkepunimit të marrë përsipër që të realizojë dhe të përcaktuar në “Kontratën bashkimi shoqërishtë”, të nënshkruar më datë 22.06.2023.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka dokumentacioni i sipërpërmendur i dorëzuar nga ana e shoqërisë “PRIMIUS ALBANIA” SHPK është vlerësuar jo i plotë, pasi nuk ka paraqitur vërtetim nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe konkretisht nuk ka paraqitur vërtetim nga Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA.

III.1.13. Nisur nga analiza e mësipërme, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “PRIMIUS ALBANIA SHPK & NEXIA AL CONSULTING SHPK” dhe konkretisht operatori ekonomik “PRIMIUS ALBANIA” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në Shtojcën 8, pika 2.1.3 të dokumenteve të tenderit të modifikuara për sa i përket dëshmimeve për realizimin e shërbimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të fituesit, pasi ka dorëzuar *kontratën me nr.prot 01/1, datë 11.01.2023, të lidhur midis shoqërisë “PRIMIUS ALBANIA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A, me objekt: “Përditësim i programit të faturimit, migrim i të dhënave dhe ëeb-service për pagesat e faturat e ujit të pijshëm”, me vlerë 6.590.000 lekë pa-TVSH, me afat 12-muaj nga data e lidhjes së kontratës, shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:*

- Aneksi 1 “Termet e referencës” me numër protokolli nr. 01/02 prot, datë 11.01.2023.
- Formular i kontratës nr. 01/3 prot, datë 11.01.2023
- Faturë tatimore elektronike nr. **16/2023**, datë 10.02.2023, të lëshuar nga shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK për autoritetin kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA, me objekt: “*Zh& adaptim i sist te faturimit dhe arketimit, si dhe Përshtatje & Migrim i të dhënave të ujësjetllësit*”, me vlerë 1.890.000 leke (pa-TVSH).
- Faturë tatimore elektronike nr. **30/2023**, datë 17.03.2023, të lëshuar nga shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK për autoritetin kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA, me objekt: “*Prog per lex e matësave dhe integrim me Prog e fat, si dhe Pajisje PDA per leximin e matësave*”, me vlerë 3.940.000 leke (pa-TVSH).
- Faturë tatimore elektronike nr. **50/2023**, datë 26.04.2023, të lëshuar nga shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK për autoritetin kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA, me objekt: “*Zhvill 7 implementim Shërb të pagesave Online*”, me vlerë 760.000 leke (pa-TVSH).

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për sa i përket pretendimit se dokumentacioni i sipërpërmendur nuk është i plotë, pasi nuk ka paraqitur vërtetim nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe konkretisht nuk ka paraqitur vërtetim nga Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA, Komisioni gjykon, se referuar dhe analizës së mësipërme të këtij kriteri kualifikues, dokumentacioni i dorëzuar nga shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK është i plotë, pasi ka dorëzuar kontratën nr.prot 01/1, datë

11.01.2023, të lidhur midis shoqërisë “PRIMIUS ALBANIA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A dhe faturat taimore përkatëse për të gjithë vlerën e kësaj kontrate, duke e plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.1 të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi dhe për më tepër vlera e këtyre faturave e plotëson vlerën e kontratëve të ngjashme në raport me përqindjen e bashkëpunimit të përcaktuar në këtë kriter kualifikues.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “PRIMIUS ALBANIA SHPK & NEXIA AL CONSULTING SHPK” për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të dhënë nga KVO-ja si në vijim: “Referuar pikës 2.3.2 të Kriterëve për Kualifikim OE duhet të dëshmojë që ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar. OE duhet të paraqesë kontratat e punës, certifikatat përkatëse si dhe listëpagesat. Në kundërshtim me këtë pikë OE nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentacionet e sipërcituara”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit të modifikuara “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.2 është parashikuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

“2.3.2 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar. Pjesë e stafit të Operatorit Ekonomik duhet të jenë të paktën:

- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje infrastrukture;
- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje netëork-u;
- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni ëeb/mobile.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operoret Ekonomikë duhet të paraqesin kontratat e punës, certifikatat përkatëse si dhe listëpagesat e muajit Shkurt 2023

(Kjo kerkese do të konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).”.

III.2.2. Në shtojcën 9 të dokumenteve standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutuar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- 1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
- 2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*
- 3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
- 4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
- 5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.**
- 6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).**

-
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
 8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
 9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura	Po [] Jo []

me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.2.3. Nga verifikimi në sistemin elektronik, u konstatua se shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK ka dorëzuar ofertë në këtë procedurë prokurimi si përfaqësuese e bashkimit të operatorëve ekonomikë “PRIMIUS ALBANIA SHPK & NEXIA AL CONSULTING SHPK”. Ky bashkim operatorësh ekonomikë është krijuar në bazë të “Kontratë bashkimi shoqërishtë”, të nënshkruar më datë 22.06.2023, ku këta dy operatorë ekonomikë kanë rënë dakord që të krijojnë këtë bashkim shoqërishtë për të dorëzuar ofertë në këtë procedurë prokurimi objekt-ankimi, duke përcaktuar përqindjen e pjesëmarrjes dhe zërat konkretë të shërbimeve që marrin përsipër që të kryejnë në rast se shpallen fitues, si më poshtë:

- *Shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK do të mbulojë 90.67 % të angazhimit të kontratës kryesore me autoritetin kontraktor, duke marrë përsipër të realizojë zërat e shërbimit si në vijim: “Zërin; ‘Ristrukturim dhe migrim i B të sistemit të faturimit AL Billing’ dhe zërin ‘Ngritje dhe konfigurim Proxy Server’.”.*
- *Shoqëria “NEXIA AL CONSULTING” SHPK do të mbulojë 9.33 % të angazhimit të kontratës kryesore me autoritetin kontraktor, duke marrë përsipër të realizojë zërin e shërbimit si në vijim: “Zërin; ‘Ngritje dhe konfigurim i AD group policies’.”.*

III.2.4. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të këtij kriteri, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik të sipërpërmendur dhe konkretisht shoqëria “PRIMIUS ALBANIA” SHPK dhe shoqëria “NEXIA AL CONSULTING” SHPK për plotësimin e kriterit kualifikues të shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit të modifikuar “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.2 ka paraqitur në sistem dokumentacionin si më poshtë:

Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “PRIMIUS ALBANIA” SHPK, ku në Seksionin B ka deklaruar si më poshtë:

B: DEKLARATË**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [<input checked="" type="checkbox"/>] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 2 (dy) Donald Merizaj Genti Mujollari</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve Donald Merizaj: Ekspert i certifikuar për zhvillimin dhe mirëmbajtje aplikacioni ëeb/mobile.</p> <hr/> <p>Genti Mujollari Ekspert i certifikuar për zhvillimin dhe mirëmbajtjen aplikacioni ëeb/mobile Ekspert i certifikuar për zhvillimin dhe mirëmbajtje netëork</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p>

Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik "NEXIA AL CONSULTING" SHPK, ku në Seksionin B ka deklaruar si më poshtë:

B: DEKLARATË**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [<input checked="" type="checkbox"/>] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 2 (dy) Xhulia Mustafaraj Ina Marku</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve Xhulia Mustafaraj: Ekspert i certifikuar për zhvillimin dhe mirëmbajtje infrastrukture. Ekspert i certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje netëork</p> <hr/> <p>Ina Marku Ekspert i certifikuar për zhvillimin dhe mirëmbajtje infrastrukture</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p>

III.2.5. Në nenin 77, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.6. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 4, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.2.7. Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë” ë ligjit nr. 162/2020, datë 23 .12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.2.8. Në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” ë Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

8. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.
9. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.
10. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.
11. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën

përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

12. *Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.*
13. *Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*
14. *Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.*

III.2.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për

operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.11. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër ankimesi ka dorëzuar secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë *“PRIMIUS ALBANIA SHPK & NEXIA AL CONSULTING SHPK”* ka dorëzuar Shtojcën 9 *“Formularin përmbledhës i vetëdeklarimit”*, ku kanë deklaruar se disponojnë në stafin e tyre specialistët e kërkuar në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit të modifikuara. Po në këtë kriter kualifikues autoriteti kontraktor ka përcaktuar se: *“Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimit dokumentin e deklaruar si më lart”*, ku në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në kriterin kualifikues të pikës 2.3.2 të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit të modifikuara dhe konkretisht të paraqitjes së dokumenteve provuese si kontratat e punës, certifikatat përkatëse si dhe listëpagesat e muajit Shkurt 2023, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi deklaratimet e paraqitura nga operatori ekonomik ofertues. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë *“PRIMIUS ALBANIA SHPK & NEXIA AL CONSULTING SHPK”* rezulton, se në përmbushje të kriterit më sipër ka dorëzuar Shtojcën 9 *“Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit”* të secilit prej anëtarëve të këtij bashkimi operatorësh, ku secili prej tyre në Seksionin B kanë deklaruar se disponojnë përkatësisht si më poshtë:

Shoqëria *“PRIMUS ALBANIA”* SHPK ka deklaruar se disponon 2 (dy) punonjës, ku njëri është ekspert i certifikuar për zhvillimin dhe mirëmbajtje aplikacioni ëeb/mobile, ndërsa tjetri është ekspert i certifikuar për zhvillimin dhe mirëmbajtjen aplikacioni ëeb/mobile dhe ekspert i certifikuar për zhvillimin dhe mirëmbajtje netëork.

Shoqëria *“NEXIA AL CONSULTING”* SHPK ka deklaruar se disponon 2 (dy) punonjës, ku njëri është ekspert i certifikuar për zhvillimin dhe mirëmbajtje infrastrukture dhe ekspert i certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje netëork, ndërsa tjetri është ekspert i certifikuar për zhvillimin dhe mirëmbajtje infrastrukture.

Në këtë kuadër KPP gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimesi ka deklaruar, se ka në disponon në stafin e tij punonjësit e duhur sipas profileve që ka kërkuar autoriteti kontraktor në kriterin kualifikues të pikës 2.3.2 të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit të modifikuara duke specifikuar llojin e certifikatës për secilën prej profileve të kërkuara. Në

rastin konkret arsyeja e skualifikimit e dhënë nga KVO-ja dhe konkretisht pretendimi se bashkimi i operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin provues për disponimin e këtyre punonjësve të profilizuar dhe konkretisht nuk ka paraqitur kontratat e punës, certifikatat përkatëse për secilin prej punonjësve të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe nuk ka paraqitur listëpagesën e muajit Shkurt 2023 për secilin prej anëtarëve të këtij bashkimi shoqërisht nuk qëndron, pasi paraqitja e dokumentave të sipërpërmendura janë objekt i verifikimit në një moment tjetër procedural, siç është faza përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë, pasi legjislacioni i prokurimit publik i njej të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues për asyet më sipër për mospërmbushje të pikës 2.3.2 të kriterëve të veçanta, lidhur me paraqitjen e kontratat e punës, certifikatat përkatëse për secilin prej punonjësve të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe nuk ka paraqitur listëpagesën e muajit Shkurt 2023 për secilin prej anëtarëve të këtij bashkimi shoqërisht, nuk është i drejtë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallrave shërbimeve apo punëve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin autoritetit mbi mosmarrjen në shqyrtim të ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “*PRIMIUS ALBANIA SHPK & NEXIA AL CONSULTING SHPK*” me arsyen se: “*Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt J66902052A është në proces likuidimi, pasi që nga data 01.09.2023 ka transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet tek subjekti me kompetenca të përbashkëta Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt-M378197010.*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në datën 26.06.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.3.2. Në datën 05.07.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “PRIMUS ALBANIA ” SHPK	1.125.000 leke	skualifikuar
2. “Ei3 Softëare Solution” SHPK	1.170.000 leke	skualifikuar

III.3.3. Në datën 05.07.2023, operatori ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Referuar pikës 2.3.1 pika b) të Kritereve për Kualifikim OE duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore e shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi.

Primus Albania nuk ka paraqitur një vërtetim të tillë.

Referuar pikës 2.3.1 pika b) të Kritereve për Kualifikim OE duhet të paraqesë faturë tatimore të shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi.

Nexia Consulting nuk ka paraqitur një dokument të tillë.

Referuar pikës 2.3.2 të Kritereve për Kualifikim OE duhet të dëshmojë që ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar. OE duhet të paraqesë kontratat e punës, certifikatat përkatëse si dhe listëpagesat. Në kundërshtim me këtë pikë OE nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentacionet e sipërcituara.”

III.3.4. Me datë 01.09.2023 është publikuar në SPE njoftimi i anulimit të procedurës.

III.3.5. Në datën 06.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3396 dhe me nr. 2176/2023 prot., datë 06.09.2023 e bashkimi të operatorëve ekonomikë “PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK”, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe kundërshtimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

III.3.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2176/2 prot, datë 06.09.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK” kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3396, dhe me numër protokoll nr. 2176/2023, datë 06.09.2023.

III.3.7. Në datën 08.09.2022, bashkimi i operatorëve ekonomikë “PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK” ka riparaqitur formularin e ankesës, protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr. 2176/3 prot., datë 08.09.2023, duke kërkuar kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe

kundërshtimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

III.3.8. Në datën 12.10.2023, nëpërmjet shkresës nr. 2176/4 prot., me objekt: *“Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesat e operatorit ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK”*, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm shoqëruar me dokumentacionin përkatës, lidhur me veprimet e kryera nga autoriteti juaj kontraktor sipas parashikimeve të nenit 111 dhe nenit 114 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”*.

III.3.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 1198/1 prot., datë 17.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2174/5 prot., datë 23.10.2023 me objekt *“Informacion në lidhje me shkresën nr. 2176/4 prot., datë 17.10.2023”* është depozituar nga Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, në Komisionin e Prokurimit Publik, akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes, ku konstatohet, se nuk e ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik *“PRIMUS ALBANIA” SHPK* duke argumentuar:

“Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 2176/4 prot, datë 12.10.2023, të protokolluar nga jonë me nr. 1198 prot, datë 16.10.2023, në lidhje me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “PRIMIUS ALBANIA shpk & NEXIA AL CONSULTING sh.p.k”, për procedurën e prokurimit me objekt “Ristrukturim dhe megrim i DB të sistemit të faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy he AD” me nr. reference 64461-03-31-2023 të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Shkodër, ju informojmë si më poshtë:

Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt- J66902052A është në proces likuidimi, pasi që nga data 01.09.2023 ka transferura të gjitha të drejtat dhe detyrimet tek subjekti me kompetenca të përbashkëta Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. Nipt - M378197010.

Ky transferim bazohet në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin, trajtimit dhe përpunimit e ujerave të ndotura”, në vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 38, datë 26.07.2022 “Për pjesmarrjen e Bashkisë Shkodër në subjektin me kompetenca të përbashkëta, me qëllim kryerjen e shërbimeve ëte furnizimit me ujë të pishëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujerave të ndotura”, në vendimin nr.3, datë 10.07.2023 të Asamblesë të Aksionarëve “Për zmadhimin e kapitalit dhe pranimin të aksionarit të ri Ujësjellës Kanalizime Shkodër”, në Kontratën noteriale për transferim aktivitetit nr. repertori 2722, datë 13.07.2023.

Për sa më sipër, referuar dosjes së prokurimit, Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr. nipt-J66902052A ka anuluar procedurën e tenderimit bazuar në proces -verbalin e vlerësimit të mbajtur nga KVO-ja dhe te me botimin e anullimit të procedurës publikuar në buletin nr.75, datë 04.09.2023.

Ankesa e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik "PRIMIUS ALBANIA shpk & NEXIA AL CONSULTING sh.p.k", nuk është shqyrtuar, për dy arsye:

Së pari; Ujësjetës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt- J66902052A ka mbyllur aktivitetin, pasi ky subjekt nga data 01.09.2023 ka transferuar të drejtat dhe detyrimet tek Shoqëria Rajonale Ujësjetës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt-M378197010, për rrjedhojë nuk ka asnjë të punësuar, përveç likuidatorit të shoqërisë dhe anëtareve të këshillit të administrimit.

Së dyti: Shoqëria Rajonale Ujësjetës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt- M378197010, nuk e ka shqyrtuar ankesën, për arsye se ankesa e bërë nga bashkimi i operatoreve ekonomik "PRIMIUS ALBANIA shpk & NEXIA AL CONSULTING sh.p.k" nuk i është drejtuar Shoqërisë Rajonale Ujësjetës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt- M378197010, por Ujësjetës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt- J66902052A. Në këto kushte e kemi patur të pamundur nga ana procedurale për të marrë në shqyrtim ankesën.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë;

Kriteret kualifikuese të DST-ve

Vendim i KPP-së nr. 475/2023

Shtojcë për ndryshim të dokumentave të tenderit nr. 1133 prot, datë 13.06.2023

Proces-verbalin e vlerësimit të mbajtur nga KVO-ja, datë 04.07.2023

Kërkesë drejtuar KPP-së për heqje pezullimi të procedurës nr. 1247 prot, datë 07.07.2023

Vendim KPP-së nr. 596/2023

Vendim KPP-së nr. 642/2023

Botim i anulimit të procedurës nr. buletini 75, datë 04.09.2023.”.

III.3.10. Në nenin 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimi publik” parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;

b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;

d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.

2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.

3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.

4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimit sipas parashikimeve të nenit 110 të këtij ligji.”

III.3.11. Në nenin 97 pika 2, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor: a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.”.

III.3.12. Në nenin 100, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga komisioni i prokurimit publik.

2. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti/enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur, brenda 5 (pesë) ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga komisioni i prokurimit publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113, të LPP-së, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

3. Në rastin kur, për shqyrtimin e ankesës, autoriteti/enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar, afati nuk duhet të tejkalojë 30 (tridhjetë) ditë. Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni komisionin e prokurimit publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

4. Autoriteti/enti kontraktor merr vendim, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 114, të LPP-së, dhe vë në dijeni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, komisionin e prokurimit publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë komisionit të prokurimit publik, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4, të këtij neni.”.

III.3.13. Në pikën 1-5, të kreut II “Riorganizimi i sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” parashikohet se;

“1. Për kryerjen e funksioneve në dobi të përbashkët dhe përmirësimin e cilësisë të shërbimeve të ofruara në sektorin e furnizimit me ujë, si dhe largimit, trajtimit e përpunimit të ujërave të ndotura, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore që bien dakord për riorganizimin e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, që ushtrojnë veprimtarinë brenda kufijve të juridiksionit territorial të tyre, nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, sipas formatit tip të përcaktuar në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të marrëveshjes së bashkëpunimit, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, riorganizohen si subjekte me kompetenca të përbashkëta (në vijim, SKP), të cilat janë shoqëri të reja aksionare të krijuara sipas sistemit të administrimit me dy nivele, në përputhje me formatin e statutin tip, të përcaktuar në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Në momentin e krijimit, SKP-së i transferohen të gjitha të drejtat, detyrimet, si dhe veprimtaria ekonomike e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore.

4. Riorganizimi i SKP-ve, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij kreu, fillon në vitin 2022 dhe përfundon sipas një programi të bashkërenduar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

5. Marrëveshja hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga palët dhe është marrë shprehja e ligjshmërisë së marrëveshjes nga ana e prefektit të qarkut/prefektëve të qarqeve, sipas kërkesave të nenit 14, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.”.

III.1.14. Nisur nga arsyeja e dhënë nga autoriteti kontraktor për mosmarrjen në shqyrtim të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimes, si dhe veprimet e autoritetit kontraktor Ujësjellës Kanalizime Shkodër SH.A, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi sepse në rastin konkret arsyeja që ka përdorur autoriteti kontraktor për mosmarrjen në shqyrtim të ankesës së sipërpëmendur nuk qëndron, sepse autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Shkodër SH.A, e ka kaluar veprimtarinë e tij te një autoritet tjetër kontraktor, si Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, në bazë të një akti nënligjor siç është VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i cili në vetvete ka përcaktuar procedura dhe afate kohore që duhen ndjekur për secilën prej procedurave deri në finalizimin e krijimit të shoqërive me përgjegjësi të përbashkët (SKP) në kuptim të aktit nënligjor të mësipërm. Në këtë kuadër jemi përballë një procesi që ka filluar në muajin maji të vitit 2022 dhe autoritetet kontraktore që do të riorganizoheshin sipas këtij akti kanë patur në

dispozicion procedura dhe afate kohore të qarta dhe nuk mund të jemi kurrësi përballë rrethanave të paparashikueshme siç autoriteti kontraktor ka shprehur në arsyen e mosmarrjes në shqyrtim të ankesës. Nga ana tjetër bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik konkretisht nenin 98 i ligjit nr. 162 “Për prokurimin publik”, si dhe neneit 97 pika 2 dhe nenit 100 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kemi një akt administrativ të KVO-së së autoritetit kontraktor (vendimin e KVO-së), i cili pas shqyrtimit të ofertave të paraqitura ka skualifikuar të gjitha ofertat e dorëzuara duke moskonkluduar me asnjë ofertë fituese dhe duke anuluar këtë procedurë prokurimi, si dhe duke i njoftuar operatorët ekonomik pjesmarrës për anulimin e kësaj procedure prokurimi objekt-ankimi.

Po ashtu sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” shoqëritë rajonale ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve (në rastin konkret autoritetit kontraktor Ujësjellës kanalizime Shkodër SHA) pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të marrëveshjes së bashkëpunimit, riorganizohen si subjekte me kompetenca të përbashkëta (në vijim SKP) të cilat janë shoqëri të reja aksionare të krijuara sipas sistemit të administrimit me dy nivele (në këtë rast Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A).

Akoma më tej, në pikën 3, paragrafi i fundit i kreut II të aktit nënligjor më sipër përcaktohet se: *“Në momentin e krijimit, SKP-së i transferohen të gjitha të drejtat, detyrimet, si dhe veprimtaria ekonomike e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore.”* Duke analizuar situatën më sipër, ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe aktin nënligjor përkatës mbi riorganizimin e shoqërive ujësjellës kanalizime ekzistuese si shoqëri me kompetenca të përbashkëta, KPP gjykon, se të gjithë të drejtat edhe detyrimet që i kanë lindur shoqërisë ekzistuese të Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sh.A nga vendimi i KVO-së së autoritetit kontraktor mbi vlerësimin e procedurës së prokurimit dhe publikimit e njoftimit të anulimit, i transferohen SKP-së, pra në rastin konkret Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër Sh.A, e cila duhet të vazhdojë konform parashikimeve të mëtejshme të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, me hapat e mëtejshëm për finalizimin e kësaj procedure prokurimi. Në këto kushte, ashtu siç ka theksuar më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se të gjithë të drejtat edhe detyrimet që i kanë lindur shoqërisë ekzistuese të Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sh.A nga vendimi i KVO-së së autoritetit kontraktor mbi vlerësimin e procedurës dhe publikimit e njoftimit të fituesit paraprak, i transferohen SKP-së, pra në rastin konkret Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër, e cila duhet të vazhdojë konform parashikimeve të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik me hapat e mëtejshëm për finalizimin e kësaj procedure prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të

Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e bashkimi i operatorëve ekonomikë “*PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK*” në procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. *REF-64461-03-31-2023*, me objekt: “*Ristrukturim dhe megrim I DB te sistemit te faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD*”, me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 26.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës-Kanalizime Shkodër SH.A.
 2. Të anulojë vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK*” duke e kualifikuar atë.
 4. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, si shoqëri me kompetenca të përbashkëta, të vazhdojë konform parashikimeve të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik me hapat e mëtejshëm për finalizimin e kësaj procedure prokurimi.
 5. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër SH.A, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*PRIMUS ALBANIA*” SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

